



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT BESNIK BAJRAKTARI

Nr. 719/9 i Aktit

Tiranë, me 28.03.2022

**URDHËR**  
**PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

**Drejtuar :** QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT (Q.K.B)

**Për dijeni:** debitorit Shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k

kreditorit Shoqëria “R-T-ELIS” sh.p.k



Unë Besnik Bajraktari, me detyrë përmbarues gjyqësor privat pranë shoqërisë “Zyra Përmbarimore Bajraktari” sh.p.k, me numër identifikimi L51526008U, nr. liçence 56, datë 21.09.2010, pasi studiova dosjen përmbarimore nr. 719 datë 15.03.2022, që i’u përket palëve me:

**Kreditor :** Shoqëria “R-T-ELIS” sh.p.k

**Debitor :** Shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k

**Objekt :** Pagim detyrimi

**KONSTATOVA :**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit nr. 11258 regj. them. datë 02.03.2022, për zbatimin e titullit ekzekutiv faturë tatimore shitje nr. 21 nr. serie 98385021 datë 17.12.2020, në bazë të cilit debitori Shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k është i detyruar të paguajë në favor të kreditorit Shoqëria “R-T-ELIS” sh.p.k detyrimin që rrjedh sipas faturës tatimore, tarifën përmbarimore (*Udhëzimi nr. 385/7 datë 28.06.2017*) si dhe kamat vonesat ligjore sipas Ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, deri në ekzekutimin e plotë të vendimit të gjykatës.

Në referim të nenit 517 të K.Pr.Civile, janë kryer procedurat për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, por debitori nuk ka përmbushur këtë detyrim në afatin e caktuar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Në referim të neneve 519, 527 të K.Pr.Civile

**URDHEROJ :**

1.Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet/kuotat e regjistruara në emër të debitorit Shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, NIPT L72031013B.

2.Per veprimet ose mosveprimet tuaja, duhet të na vini në dijeni, brenda 5 diteve nga marrja e ketij njoftimi.

3.Ne rast të kundert, ndaj personave shkaktare, do të aplikojmë gjobe në masën 50 000 leke, në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile.



**PËRMBARUESI GJYQËSOR**  
**Besnik Bajraktari**